

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Së pari, dëshiroj t'u jap një përshëndetje të përzemërt banorëve të Divjakës, grave dhe burrave guximtarë, të cilët me guximin e tyre i thyen sot turinjtë mafias së Edi Ramës, i përmbysën traun antiligjor, antiqytetar në rrugën e tyre shekullore. Nderim të madh për ju! Opozita do të qëndrojë prapa çdo shqiptari që ka një kauz të drejtë.

Zonja dhe zotërinj,

Sot këtu flitet për integrimin europian dhe për procesin e integritit. E vërteta është se ky proces në tërësinë e tij, për normat, ligjet dhe standardet që zbaton në këtë vend duhet të sjellë gjithnjë e më shumë Europë.

Çfarë ka ndodhur? Ka ndodhur ajo që është më e rënda, sepse për fat të keq Shqipëria çdo ditë, javë e muaj është shndërruar në një eksportues të frikshëm të krimit në Europë. Shqipëria e etiketuar nga Departamenti i Shtetit si epiqendër operacionale e organizatave kriminale të rajonit të Europës, Lindjes së Mesme, Amerikës së Veriut dhe të Amerikës së Jugut, po eksporton gjithnjë e më shumë drogë, krim, krim-drogë dhe para të pista. Ajo sot ka indeksin më të lartë të ndërtimit në Europë, që i tejkalon me tre herë indeksin e ndërtimit në vendet nordike, me çmimet shumë të larta të apartamenteve, të tretat në Europë më të larta, ajo është shndërruar sot në vrimën e zezë të kontinentit për larjen e parave të pista. Kjo është e vërteta.

Ligjet, praktikat që miratoni dhe emërimet që bëni, kanë krimin dhe drogën si kriter themelor. Kjo është e vërteta. Le të ndjekim pak standardet e tjera. Integrimi nënkupton më shumë përgjegjshmëri para ligjit, më shumë transparencë në funksionimin e shtetit ligjor dhe ekonomisë së tregut. Për sa i përket shtetit ligjor, ju vendosët monizmin e plotë, dhe ky monizëm e ka katandisur Shqipërinë katër shkallë më poshtë, katër vende më poshtë sesa diktatura komuniste e Vietnamit; ky monizëm e ka katandisur Shqipërinë 53 vende më poshtë se Kosova e lirë dhe e pavarur; ky monizëm ka vendosur këtu tiraninë e vërtetë të prokurimeve sekrete, të cilat janë rritur 20 herë; ka vendosur praktikat e vjedhjeve të papara në Europë dhe në botë. Dje "SKAP-i" juaj lëshoi disa urdhra arresti (shumicën i kishin lajmëruar të ikin) për djegësit, për njerëzit të cilët absolutisht nuk janë gjë tjetër veçse ushtarë të mjerë, rrogëtarë të sipërmarrjes së Edi Ramës, Engjëll Agaçit, Arben Ahmetajt, Erion Veliajt dhe Lefter Kokës.

Të dashur qytetarë, Pse e them unë këtë? E them dhe do ta përsëris njëmijë herë, se kur një Kryeministër firmos për t'i dhënë një kompanie pa asnjë eksperiencë, firmos në kundërshtim me qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Prokurimeve Publike për të prokuruar në negociata të mbyllura, ai e bën këtë vetëm kur sipërmarrja është e tij, se nuk mund ta bëjë kurrë as për vëllain e tij. Kryeministri firmosi për t'i dhënë 8% bonus një kompanie, për të cilën, kjo, që drejton seancën sot, të vetmen meritë të saj në jetën publike ka një shkresë, ku i thotë zotit Kryeministër se Integrated Energy nuk ekziston, se nuk ekzistonte. Në datën 7 dhjetor Kryeministri firmosi për t'i dhënë 8% bonus. Po, more, po! Cilës kompanie iu dha 8% bonus? Kompanisë për të cilën ministrja e shtetit thoshte se nuk ekziston kurrkund?! Dhe kishte të drejtë, sepse kompania u themelua në datën 31 gusht të vitit 2017, 8 muaj më vonë!

Kur bëhen këto, ore miq? Këto bëhen vetëm kur vjedh, vjedh e vetëm vjedh Kryeministri, kur vjedh sekretari i Përgjithshëm, kur vjedh ministri i Financave. Unë e di që keni burgosur Lefterin, dhe nuk i dal për zot atij, por çfarë them, e them këtu: Lefteri nuk kishte asnjë qindarkë në buxhetin e ministrisë. Lefteri nuk bëri gjë tjetër veçse krijoi kanalin e vjedhjes për Edi Ramën, Arben Ahmetajn, Engjëll Agaçin, Erion Veliajn dhe ndau diçka me ta. Por le të shkojmë më tej. Çfarë po ndodh me portin e Durrësit? Portin e Durrësit Edi Rama po e merr së bashku me vëllezërit Karriç. Ju mund të pyesni: “Pse me vëllezërit Karriç?”. Sepse vëllezërit Karriç janë aksionerët kryesorë në kompaninë që ndërtoi Waterfront-in në Beograd. Është identike, e njëjta kompani!

Ti që thua “gënjen”, nuk ke fytyrë! Ti gënjen dhe mbron hajdutët! Është e njëjta kompani dhe kjo kompani vjen e ndërton me vëllezërit Karriç dhe vëllezërit Rama, Olsin dhe Edin. Merr 60 % të aksioneve, që nuk i ka Alabari, dhe do të marrë dhuratë 200 hektarë. Deri para 3 ditësh na thanë: “Janë 80”, ndërsa dje zonja Balluku tha: “Janë 200”, pra në një aferë prej të paktën 4 miliardë dollarësh truall, në një aferë në të cilën, Rama, Olsi, Vuçiçi, Nebojsa e si quhet ai tjetri, marrin të paktën secili minimumi nga 300-400 milionë euro, në një aferë për të cilën çdo shqiptar do të paguajë të paktën 1000 dollarë për ndërtimin e portit të ri, i cili kushton 2 miliardë dollarë; në një aferë në të cilën do t'u grabisni shqiptarëve pasurinë më të madhe publike që kanë sot dhe që kanë pasur ndonjëherë.

Çfarë keni ju me Europën? Ju vetëm me Europën nuk keni asgjë! Si ka mundësi?! Çfarë ju lidh ju me Europën?! Ju jeni të gjithë për ekzil, jo në Europë, por në mbretërinë e vjedhjes, në mbretërinë e korrupsionit, të drogës dhe të krimit!